



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L -261

**PËR VETERANËT E LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË
KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR VETERANËT E LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË
KOSOVËS**

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në beneficione të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione për Veteranët e UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave, siç është përcaktuar në nenin 12 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve,

veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

2. Ky ligj nuk zbatohet ndaj kategorive tashmë të trajtuara dhe që përfitojnë beneficione në Ligjin nr. 04/L-054.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. Lufta Çlirimtare e Kosovës (LÇK) – është lufta e armatosur e popullit të Kosovës, e udhëhequr nga UÇK – ja, me qëllim të çlirimit të Kosovës dhe sjelljes së lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës, me karakter mbrojtës dhe çlirimtar, e drejtuar ekskluzivisht kundër forcave ushtarake, policore dhe administratës okupuese të Serbisë në Kosovë;

1.2. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) – Formacion ushtarak i armatosur dhe i organizuar në baza vullnetare me uniforma dhe shenja dalluese, me njësi organizative dhe zinxhir komandues të drejtuar nga Shtabi i Përgjithshëm, nën kontrollin civil të udhëheqjes politike, me mision të qartë për mbrojtjen e popullit të Kosovës dhe çlirimin e vendit nga forcat ushtarake, policore dhe administrata okupuese e Serbisë në Kosovë;

1.3. Veteran i UÇK –së - pjesëmarrës në luftën për çlirimin në Kosovë si:

1.3.1. Invalid i luftës së UÇK –së –luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (burgosuri) i UÇK- së, i cili ka pësuar plagë , lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës , me shkallë të invaliditetit së paku 10%;

1.3.2. Veteran luftëtarë i UÇK –së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK- së , dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës;

1.3.3. I internuar i UÇK së – secili person i cili për shkak të veprimtarisë së tij si pjesëtarë i UÇK- së është arrestuar gjatë periudhës 1997 -1999, dhe mbajtur në burg nga forcat e Serbisë;

1.3.4. Pjesëtarë i UÇK së - çdo person i cili me vendim apo akt tjetër është caktuar të kryej detyra konkrete në mbështetje politike , logjistike, financiare dhe detyra të tjera të marra nga komandantët e njërive, shtabeve dhe zonave të UÇK- së, përkatësisht shtabi i përgjithshëm i UÇK- së, gjatë periudhës 1997-1999;

1.3.5. Pjesëmarrës i Luftës - ushtari, i cili është radhitur në radhët e UÇK së, ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive për të kontribuar në luftë, por për arsye të ndryshme i ka lëshuar radhët e UÇK- së, para përfundimit të luftës;

1.3.6. **Ushtari i zhdukur (i pagjetur) i UÇK- së** - veterani ose pjesëtari i UÇK- së, fati i të cilit ende nuk është zbardhur.

1.4. **SHP** - Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së;

1.5. **ZÇKL** - Zyra për çështjet e kategorive të dala nga lufta;

1.6. **SHFD** - Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së;

1.7. **OVL** - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së;

1.8. **SHIL** - Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së;

1.9. **Komisioni** - Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranit UÇK-së dhe kategorive tjera i themeluar sipas Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;

1.10. **Ministria** - Ministria përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale;

1.11. **Pensioni i Veteranit Luftëtar** - pagesa e rregullt mujore që i bëhet veteranit gjatë tërë jetës;

1.12. **Anëtarë të familjes së ngushtë** në kuptim të këtij ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore:

1.12.1. statusi i bashkësisë jashtëmartesore sipas këtij ligji përcaktohet me procedurë gjyqësore jashtë kontestimore.

1.13. **Pensioni i trashëgimtarit** - pagesa e rregullt mujore për trashëgimtarët e veteranit;

1.14. **Pensioni i zakonshëm publik** - pensionin nga fondi publik i pensionimit që Qeveria e Kosovës u paguan të gjithë qytetarëve me të drejtë pensioni, nëse është përcaktuar dhe në atë masë sa përcaktohet sipas ligjit në fuqi;

1.15. **Ligji nr. 04/L-054** - Ligji nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 30 / 31 dhjetor 2011, Prishtinë).

KREU II

KATEGORIZIMI I VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Neni 4

Kategorizimi i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

1. Duke vlerësuar lartë sakrificën dhe vuajtjet e popullit të Kosovës, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndahen në kategoritë si në vijim:

- 1.1. Veteran Invalid i luftës së UÇK-së;
- 1.2. Veteran Luftëtar i UÇK-së;
- 1.3. Veteran i Internuar i UÇK-së;
- 1.4. Veteran Ushtar i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së, dhe
- 1.5. Veteran pjesëtarë i UÇK së.
- 1.6. Veteran Pjesëmarrës i Luftës së UÇK-së.

2. Dëshmoret e Kombit dhe kategoritë e veteranëve të përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.3 dhe 1.4, të paragrafit 1. të këtij neni, trajtohen sipas Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Neni 5

Statusi i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Statusi i të gjitha kategorive të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, konstatohet nga Komisioni.

KREU III

LISTAT E VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Neni 6

Shqyrtimi i aplikimeve

1. Pas mbledhjes së aplikacioneve, të personave që kanë aplikuar për përfitimin e statusit të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Komisioni shqyrton aplikacionet dhe përpilon Listat fillestare të personave sipas kategorive përkatëse.

2. Komisioni bën publike Listat fillestare sipas kategorive përkatëse.

3. Listat fillestare mbesin publike tridhjetë (30) ditë dhe publikohen në ueb faqen e ZÇKL-së dhe në së paku dy nga mediat si dhe në të gjitha degët e OVL-së, SHFD dhe SHIL.
4. Personat të cilët për arsye të caktuara nuk kanë pasur mundësi për aplikim për njohjen e statusit të veteranit, mund të aplikojnë për njohjen e këtij statusi në bazë të kriterëve të përcaktuara me akt nënligjor të veçantë.

Neni 7

Ankesa

1. Brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditësh, që nga shpallja publike e Listave fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së, çdo aplikues, që ka prova të reja apo mendon se i është bërë e padrejtë, mund t'i drejtohet Komisionit për rishqyrtimin e kërkesës.
2. Brenda periudhës prej 3 tridhjetë (30) ditësh, që nga shpallja publike e Listave fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së, çdo qytetarë ka të drejtë që të paraqesë ankesë apo fakte lidhur me personat që janë apo që nuk duhet të jenë në Listën fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së.
3. Rishqyrtimi i kërkesës së aplikuesve dhe ankesës së qytetarëve bëhet sipas procedurave të përcaktuara për vendimmarrje të Komisionit.
4. Vendimi i Komisionit është përfundimtar në procedurë administrative.
5. Kundër Vendimit të Komisionit pala e pakënaqur ka të drejtë që të iniciojë procedurën në Gjykatën kompetente.

Neni 8

Listat përfundimtare

1. Pas përfundimit të afatit të publikimit dhe shqyrtimit të ankesave, Komisioni miraton Listat përfundimtare të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Duke u bazuar në Listat përfundimtare të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lëshon certifikatat për kategoritë përkatëse.
3. Certifikata përmban të dhëna që mundësojnë identifikimin e qartë të kategorive të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
4. Dukja, forma dhe përmbajtja e certifikatave si dhe autoriteti përkatës që i lëshon ato, përcaktohet sipas aktit përkatës nënligjor të miratuar nga Qeveria.

Neni 9 Regjistrat

Duke u bazuar në Listat përfundimtare të kategorive të dala të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,, ZÇKL-së krijon, mban dhe përditëson Regjistrat e kategorive përkatëse.

Neni 10 Pajisja me dokumente përkatëse

1. Duke u bazuar në Listat përfundimtare të kategorive të dala nga LÇK, ZÇKL lëshon Vërtetime përkatëse për personat e kategorive të përcaktuara në këtë ligj.

1. Duke u bazuar në vërtetimet e lëshuara nga ZÇKL, SHFD, OVL dhe SHIL lëshojnë Kartelat identifikuese sipas kategorive përkatëse.

3. SHFD, OVL dhe SHIL i dorëzojnë ZÇKL-së Listën e personave që janë përfitues të kartelave identifikuese.

4. Kartelat identifikuese sipas kategorive përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj, duhet të jenë të sigurisë së lartë dhe të përmbajnë identitetin e plotë dhe fotografinë.

5. Forma dhe përmbajtja e Librezës, përcaktohet sipas aktit përkatës nënligjor të miratuar nga Qeveria.

Neni 11 Familja e veteranit

1. Me vdekjen e veteranit Familjes i jepet një dokument që vërteton se është familje veterani - Dekoraten: Familje Veterani.

2. Dekorata: Familje Veterani, lëshohet nga Zyra.

3. Familjet e veteranëve që kanë ndërruar jetë para hyrjes në fuqi të këtij ligji pajisen me Dekoraten: Familje Veterani.

Neni 12 Dokumentacioni i Komisioni

1. Pas përfundimit të punës i gjithë dokumentacioni i Komisionit i dorëzohet ZÇKL-së.

2. Dokumentacioni i Komisioni trajtohet dokument i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin e informatave dhe ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 13
Deklarata e rreme dhe falsifikimi i dokumenteve

Çdo person, i cili me vetëdije, paraqet deklaratë jo të vërtetë (të rreme) apo prezanton dokumente të falsifikuara, me qëllim të përfitimit të statusit të pjesëmarrësit të UÇK-së dhe të përfitimit të të drejtave dhe beneficioneve, të përcaktuara sipas këtij ligji, ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi lidhur me paraqitjen e deklaratës së rreme dhe falsifikim të dokumenteve.

KREU IV
TË DREJTAT NË BENIFICIONE PËR VETERANËT LUFTËTAR TË UÇK-së

Neni 14
Dita e Veteranit

Dita e Veteranit shënohet me 30 dhjetor, për të përkujtuar sakrificën, angazhimin dhe kontributin e veteranëve për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës.

Neni 15
Realizimi i të drejtës në pension dhe beneficione

Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së.

Neni 16
Pensioni personal i veteranit luftëtar

1. Veterani Luftëtar i UÇK-së realizon Pensionin personal të veteranit luftëtar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
2. Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë.
3. Veterani Luftëtar i UÇK-së i cili merr pension të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, sipas Ligjit nr. 03/L-100 për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 41 / 01 nëntor 2008), duhet të përcaktohen se cilin pension do të marrin.
4. Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit.

Neni 17
Shtesa në Pensionin e pleqërisë

Veterani Luftëtar i UÇK-së i punësuar në sektorin publik dhe privat pas arritjes së moshës ligjore të pensionimit ka të drejtë në shtesë të pensionit për barazim me pensionin e veteranit luftëtar.

Neni 18
Lartësia e shumës së pensioneve

Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë.

Neni 19
Parashtrimi i kërkesës për pension

1. Kërkesën për Pension të Veteranit Luftëtar i UÇK-së, mund ta parashtroj veterani, personi i autorizuar nga ai ose trashëgimtari(ët) pas vdekjes së veteranit.
2. Për realizimin e së drejtës në pension, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Zyrën Rajonale të Departamentit të Ministrisë për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe viktimat civile të luftës.
3. Përfituesi, ose trashëgimtari(ët) i/e tij/saj është i obliguar të informojë me shkrim administratën pensionale të Kosovës për çdo ndryshim të rrethanave të cilat ndikojnë në fitimin e të drejtës për marrjen e pensionit.
4. Për realizimin e së drejtave në beneficione tjera, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Ministrinë dhe institucionet tjera përkatëse.
5. Administrata pensionale e Kosovës, si njësi administrative brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, menaxhon dhe administron pagesën e pensioneve të caktuar me këtë ligj.
6. Pensioni i përcaktuar me këtë ligj kërkohet sipas procedurave të parapara për pensionin e zakonshëm publik.

Neni 20
Pensionet e trashëgimtarëve

1. Pas vdekjes së veteranit, të drejtën e pensionit të trashëgimtarit e përfitojnë vetëm bashkëshorti/ja e papunësuar, fëmijët e miturit dhe prindërit e veteranit, në rastin kur nuk përfitojnë pensione nga sigurimet shoqërore.

2. Fëmijët e veteranit, të cilët janë nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare në kohën e vdekjes së tij kanë të drejtë që pas vdekjes së pensionistit të marrin pensionin e fëmijëve trashëgimtarë.

3. Mosha e rregulluar në paragrafin 2. të këtij neni ngritët në njëzetegjashtë (26) në rastet kur fëmijët vijojnë shkollimin e rregullt, brenda kohëzgjatjes së periudhës së shkollimit të rregulluar me ligj.

4. Fëmijët me aftësi të kufizuara të veteranit kanë të drejtë të marrin pensionin e fëmijëve trashëgimtarë pavarësisht nga mosha, nëse ata janë me aftësi të kufizuara në datën e vdekjes së pensionistit, sipas kushteve të njëjta të përcaktuara për pensionin e zakonshëm publik, nëse është përcaktuar dhe në atë masë sa përcaktohet sipas ligjit në fuqi.

5. Përparësitë në realizimin e të drejtave, në mes të anëtareve të familjes së ngushtë sipas këtij ligji, përfituesit i realizojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë. Anëtarët e familjes të radhës së njëjtë të trashëgimisë, do t'i realizojnë të drejtat sipas marrëveshjes së ndërsjellët. Në qoftë se marrëveshja nuk arrihet, përparësi në realizimin e të drejtës ka anëtari i familjes së ngushtë nga radhët e njëjtë trashëgimore, i cili me personin nga i cili realizohet e drejta, ka jetuar në bashkësi të njëjtë familjare.

Neni 21

Shuma e Pensionit për trashëgimtarët

Shuma e pensionit të trashëgimtarit përbëhet prej 70% të pensionit që i është paguar veteranit që ka vdekur.

Neni 22

Humbja e së drejtës për pension Pensionet e trashëgimtarëve

1. Përfituesi e humb të drejtën e tij/saj për pension të trashëgimtarëve në rast të:

1.1. vdekjes së përfituesit;

1.2. përfundimit ose ndërprerjes të shkollimit në rast se përfituesit janë mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;

1.3. shërimit nga aftësia e kufizuar.

2. Bashkëshorti/ja që lidh martesë të re, pas vdekjes së veteranit të UÇK-së, i humb të drejtat në pension dhe beneficione të përcaktuara me këtë ligj. Me këtë rast procedurat e parapara për Pensionin e zakonshëm publik hyjnë në fuqi.

Neni 23
E drejta në shërbime shëndetësore falas

1. Veteranët të UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë gëzojnë të drejtën e shërbimit shëndetësor falas sipas dispozitave ligjore në fuqi në spitalet, klinikat dentare dhe qendrat shëndetësore që financohen nga shteti, si dhe përfitojnë falas barnat për sëmundje kronike, sipas kritereve të propozuara nga ministria përkatëse për shëndetësi dhe të miratuara nga Qeveria, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Në rastet kur nuk mund të bëhet trajtimi në institucionet shëndetësore shtetërore, për pasojat shëndetësore si pasojë e luftës, veteranët gëzojnë trajtimin jashtë vendit dhe jashtë institucioneve shtetërore të shëndetësisë, sipas rregullave dhe procedurave të propozuara nga ministria përkatëse për shëndetësi dhe të miratuara nga Qeveria, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë themelojnë Qendrën e Stresit Posttraumatik për Veteranet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për rehabilitimin emocional, shpirtëror dhe të traumave si pasojë e luftës.

Neni 24
E drejta e përparësisë në punësim

1. Veteranët Luftëtar të UÇK-së dhe Pjesëtarët e UÇK së gëzojnë, në kushte te barabarta, të drejtën e përparësisë në punësim, në institucionet dhe në ndërmarrjet e sektorit publik.

2. Rregullat dhe procedurat për përparësinë në punësimin në kushte të barabarta përcaktohen nga Qeveria sipas propozimit të ministrisë përkatëse për administratë publike.

Neni 25
E drejta e udhëtimit

Veteranëve Luftëtar të UÇK-së u sigurohet falas udhëtimi me mjetet e komunikacionit urban, kurse udhëtimi ndërurban me gjysmë çmimi. Për këtë si dokument provues shërben librezja e veteranit.

Neni 26
E drejta në riaftësim profesional

E drejta në riaftësim profesional është e drejtë të cilën e realizon veterani i UÇK-së, sipas Programeve të veçanta që përgatiten nga ministria dhe miratohen nga Qeveria.

Neni 27
Lehtësirat për veteranët luftëtar të UÇK-së

1. Qeveria, varësisht nga mundësitë buxhetore, për veteranët luftëtar të UÇK-së, krijon lehtësira të ndryshme për përfitimin e granteve dhe subvencioneve në zhvillimin e bizneseve për veteranët luftëtarë si dhe lehtësira të ndryshme administrative, tatimore dhe doganore.
2. Obligohen ministritë, që nga fushëveprimi i tyre, të përgatisin dhe paraqesin për miratim në Qeveri programet e ndryshme për zbatimin e paragrafit një të këtij neni.

Neni 28
E drejta e Stazhit të dyfishtë

Stazhi i dyfishtë është e drejtë të cilën e realizojnë veteranët luftëtarë për kohën e kaluar në luftë.

Neni 29
Përkujdesja për banim

1. Përkujdesja për banim për veteranët e UÇK-së, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe nuk e kanë të zgjidhur strehimin familjar, për të cilët Qeveria e Kosovës dhe organet e pushtetit lokal sigurojnë strehim familjar përmes ndërtimit të objekteve kolektive të banimit social.
2. Organet e pushtetit lokal duhet t'u japin përparësi zgjidhjes së kërkesave për strehim të veteranëve, duke pasur parasysh kushtet, gjendjen ekonomike të tyre.

Neni 30
Përparësia e pranimit në institucionet arsimore publike

Përparësia e pranimit në institucionet arsimore publike, në kushte të barabarta, është e drejtë të cilën e realizojnë veteranët luftëtarë dhe anëtarë e ngushtë të familjes së tyre.

Neni 31
Lirimi nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik

Lirimi nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik, është e drejtë të cilën mund ta realizojnë veteranët luftëtarë dhe fëmijët e tyre.

Neni 32
Vendosja në shtëpitë e personave të moshuar

Veteranët gëzojnë të drejtën e vendosjes pa kompensim në shtëpitë e personave të moshuar.

Neni 33
Shpenzimet e varrimit

1. Ministria heq shpenzimet e varrimit të veteranit.
2. Ministria përkatëse për siguri përcakton rregullat dhe procedurat për ceremoninë e varrimit me nderime ushtarake.

KREU V
DISPOZITAT KALIMATARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34
Zyra për Çështjet e Kategorive të dala nga Lufta

1. ZÇKL, është organ qeveritar që bashkërendon dhe koordinon aktivitetet për veteranët UÇK-së të përcaktuara në këtë ligj.
2. ZÇKL bashkëpunon me OVL për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të kategorive të përcaktuara nga ky ligj.

Neni 35
Medaljet dhe ceremonitë

1. ZÇKL në bashkëpunim me organizatat e dala nga lufta dhe në konsultim me institucionet tjera përkatëse publike, përgatit aktet përkatëse për:

1.1. Njohjen dhe formën e dekoratave për kategoritë e ndryshme të përcaktuara në këtë ligj, duke përfshirë dhe mos u kufizuar në ndarjen e veteranëve luftëtarë sipas periudhave:

1.1.1. deri me datën 7 mars 1998;

1.1.2. deri me datën 31 mars 1999; dhe

1.1.3. deri më datën 12 qershor 1999.

1.2. pjesëmarrjen në ceremonitë publike të veteranëve;

1.3. përcaktimi i uniformës solemne dhe të drejtën për të veshur uniformën solemne për ceremoni;

1.4. ceremonitë e nderimit ne funeral dhe

1.5. varrimi në varrezat e veçanta.

2. Qeveria sipas propozimit të Zyrës sipas paragrafit 1. të këtij neni nxjerrë aktet përkatëse nënligjore.

Neni 36

Zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe, drejtpërsëdrejti zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 37

Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit

1. Për zbatimin e këtij ligji, në afat prej një (1) viti, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Kosovës dhe ministrinë përkatëse nxjerrin aktet përkatëse nënligjore.

2. Qeveria e Kosovës, sipas nevojës, përveç akteve nënligjore të përcaktuara në këtë ligj, mund të nxjerr edhe akte të tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 38

Gjobat

1. Me gjobë në para prej tremijë (3.000) deri pesëmijë (5.000) Euro për mos zbatimin e dispozitave të këtij ligji, do të gjobiten për kundërvajtje institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

2. Me gjobë në para prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni, do të gjobitet personi përgjegjës i institucionit kompetent dhe eprori i këtij organi.

Neni 39

Trajtimi i kërkesave në shqyrtim

1. Të gjitha kërkesat e paraqitura në Komision, të cilat janë në shqyrtim e sipër, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të kategorizohen sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj janë të pranueshme vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe asnjë person nuk mund të kërkojë realizimin e këtyre të drejtave në mënyrë retroaktive.

Neni 40
Beneficionet Subjekt i Vështirësive Fiskale

Qeveria e Kosovës obligohet në të gjitha rrethanat financiare t'i përmbush obligimet financiare që dalin nga ky ligj. Pagesat dhe beneficionet për Veteranët e UCK-ës nuk mund të reduktohen, apo eliminohen me vendim qeveritar.

Neni 41
Dispozitat Kalimtare

Nëse gjatë procesit të auditimit bëhet e ditur se disa nga këto beneficione janë përfituar në mënyrë të padrejtë, atëherë këto beneficione do të ndërpriten.

Neni 42
Zgjidhja e kontesteve

Përfituesi mund të kërkojë që çdo mosmarrëveshje që del nga ky ligj të zgjidhet në organin kompetent administrativ apo gjyqësor në bazë të ligjit në fuqi.

Neni 43
Trashëgimtarët e individëve të cilët kanë vdekur para hyrjes në fuqi të këtij ligji

Përfituesit e anëtarëve aktiv të pensionit të veteranit luftëtar të cilët kanë vdekur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë të drejtë për pensionin për trashëgimtarë.

Neni 44
Zbatimi

1. Pas miratimit të Listave përfundimtare të veteranëve dhe pjesëmarrësve nga Lufta e UÇK-së, me hyrjen në fuqi të këtij ligji kategoritë e përcaktuara në këtë ligj kanë të drejtën e shfrytëzimit të tyre.
2. Të drejtat dhe beneficionet për veteranët realizohen në pajtim me këtë ligj, pa paragjykuar dispozitat e ligjeve, si dhe të instrumenteve ligjore ndërkombëtare, të cilat njohin të drejta më të gjëra.
3. Institucionet qeveritare përkatëse, në afat prej gjashtë (6) muajsh nxjerrin aktet nënligjorë të parapara me këtë ligj.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L -261
3 prill 2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI